




ART EXPLORA FESTIVAL



ODYSSÉE
CULTURELLE
EN MÉDITERRANÉE

Pavijoni kryesor

UNDER THE AZURE

Kuratorë: Rebecca Lamarche-Vadel dhe
Blanche de Lestrang

Ekspozita *Under the Azure (Nën kaltërsi)* sipikë fillestare të sajka një mit të hititëve (hititët janë një popull i Azisë së Vogël, i cili jetonte në mijëvjeçarin e 2-të p.e.s.) sipas të cilit, çdo mbrëmje, dielli zhytej në det në momentin kur perëndonte. *Under the Azure* sjell së bashku vepra nga njëzet artistë ndërkombëtarë, historikë dhe të rinj, praktika artistike e të cilëve është formësuar si rezultat i magjepsjes nga Deti Mesdhe. Ekspozita pasqyron ëndrrat dhe frikërat që shkakton Mesdheu, nga qeniet që jetojnë në të e deri te tragjeditë që dëshmon.

© kreditet

Joana Hadjithomas dhe Khalil Joreige, Remember The Light (Kujto dritën), 2016
Jean Painlevé, Acéra ou le bal des sorcières (Acera ose vallja e shtrigave), 1972

Konceptimi/realizimi: ma-tisse / faqosja dhe dizajni: Flore Beaudelin

Jean Painlevé, *Acra ou le bal des sorcières* (*Acera ose vallja e shtrigave*, 1972)

Këto kafshë të filmuara në detin e thellë i përkasin familjes së molusqeve. Jean Painlevé i filmoi këto acera për **qëllime shkencore**, duke zbuluar imazhe të cilat, zakonisht, janë të paarritshme dhe të padukshme. Nën muzikën xhaz, lëvizja e acerave duket sikur ndjek një **koreografi** dinamike në formë shtjelle. Midis tërheqjes dhe shtytjes, artisti shfaq qenie të gjalla pothuajse të panjohura, të cilat pasurojnë jetën detare dhe kontribuojnë në ekuilibrin e **ekosistemit** tonë.

? Vini re lëvizjet e acerave. Çfarë ju kujtojnë? Disa lëvizje të sjellin ndër mend një valle! Dikush mund të mendojë për vallëzimin gjarpërues të Loie Fuller (1862-1928), valltarit të famshëm amerikan që konsiderohet si një nga pionierët e vallëzimit modern.

IMAGJINARE

Adrián Villar Rojas, *Pa titull XI* (seria "*Rilindja*"), 2023

Frigoriferi, një simbol i modernizmit, bëhet në duart e Adrián Villar Rojas korniza e një pikturë të çuditshme: një **natyrë e qetë** e ushqimeve të ngrira dhe e objekteve. Përmbajtja e këtij frigoriferi ndryshon në çdo ndalesë të anijes-muze, duke vepruar si një lloj **karte identiteti** për shtetin ku shfaqet. Dhoma e ngrirjes lëshon një dritë të ftohtë mbi përmbajtjen e saj, sikur çdo gjë është e **ngjirë në mënyrë të përkryer në kohë**, por përsëri ka mundësi të rilindë në çdo moment, siç sugjeron dhe titulli i saj.

? Shikoni me kujdes përmbajtjen e frigoriferit. Identifikoni të gjithë artikujt nga shteti ku jeni dhe imagjinoni se çfarë artikujsh mund të jenë në ndalesat e tjera.

Jean-Marie Appriou, *Black Smoker* (Muraena) (*Tymuesi i zi [Muraena]*), 2023

Baza e veprës Black Smoker (Muraena) (Tymuesi i zi [Muraena]) është një **"tymues i zi"**, një element i faunës së thellësisë së detit, i cili arrin të mbijetojë pa dritë falë simbiozës së tij me bakteret. Këtu paraqiten gjarpërinjtë e detit, të aftë të prodhojnë **dritën e tyre fluoreshente**, duke e zgjatur tymuesin ndërkohë që jetojnë në të. Ata të sjellin ndër mend aftësinë e disa qenieve të gjalla për të krijuar dritë në rrethanat më të errëta.

? Cilën bimë, kafshë ose krijesë apo krijesa njerëzore të kujton kjo skulpturë?

LËVIZJA

Joan Miró, *Gens de la mer* (*Njerëzit e detit*), 1981-1990

Këto dymbëdhjetë gravura formojnë një seri me titull People of the Sea (Njerëzit e detit). Figurat paraqiten në veprime të përditshme me forma të thjeshtëzuara, në dukje të bëra njësh me **ujin** ose me një **kafshë detare**. Në këtë seri, me ngjyra të gjalla dhe me ngjyrat e zeza të thella, Miró e shndërron Mesdheun në një skenë teatri, të mbushur me një sërë **personazhesh të jashtëzakonshme**.

? A i lexuat titujt e veprave? Me humor, Joan Miró i përmend këto personazhe si një homazh për njerëzit e Mesdheut. Veprimtaritë e përditshme janë vërejtur dhe janë renditur në një mënyrë argëtuese.

MITI

Joana Hadjithomas dhe **Khalil Joreige**, *Remember the Light* (*Kujto dritën*), 2016

E paraqitur në dy pjesë, kjo vepër ka si sfond **Detin Mesdhe**. Artistët i filmuan këto skena pranë Bejrutit në Liban, një shtet tranzit për emigrantët që shkojnë në Evropë. Në një nga ekranet duket një **shall** që valëzon në det, ndërsa videoja tjetër tregon disa objekte dhe pesë zhytës. Sa më shumë zhyten këta trupa të ndryshëm në **thellësi**, aq më shumë errësohen ngjyrat.

? Çfarë mund të imagjinoni nga objektet e zhytura? Këto imazhe të trupave që bien, na kujtojnë se njerëzit zhduken në Mesdhe ndërkohë që përpiqen të prekin Evropën.

ËNDRRA

Lydia Ourahmane, *Calypso* (*Kalipso*), 2023

Vepra e Lydia Ourahmane është një magnet shumë i madh, i zhytur në portin e çdo ndalese të ekspozitës, i cili ka tërhequr objekte, materiale ose mbetje të ndryshme, të varrosura atje. Së bashku, këto objekte përbëjnë një natyrë të qetë dhe një **peizazh të vërtetë të thesareve të zhytura në det**, pavarësisht nga vlera e tyre.

? Vini re objektet aktuale të magnetizuara. A ju befason ndonjëri prej tyre?

KALIMI

Dominique White, *The Obliteration of Nothing* (*Fshirja e asgjëje*), 2023

Kjo skulpturë është një **ansambël** objektesh dhe materialesh të ndryshme që të sjellin ndër mend detin, **lundrimin** dhe pushtimin. Për këtë vepër, Dominique White u frymëzua nga miti i Hidrës, një përbindësh ujqor me shumë koka nga mitologjia greke. Këtu, fuzhnjat e shumta paraqesin kokat e Hidrës, të cilat simbolizojnë **rreziqet** e Detit Mesdhe për ata që e kalojnë atë për të mbërritur në Evropë si pasojë e mërgimit dhe emigrimit të detyruar.

? Vini re formën e fuzhnjave. Çfarë ju bie në sy? Ato janë të përdredhura! Është e vështirë ta kapësh gjahun në këtë mënyrë... Duket sikur fuzhnjat janë kthyer kundër gjuetarit, duke kërkuar hakmarrje ndaj burrit që përpiqet të dominojë qeniet e tjera.

HORIZONTI

Luigi Zuccheri, *Pa titull*, 1965-1970

Piktori Luigi Zuccheri ka paraqitur shpesh peizazhet dhe kafshët e rajonit të tij, i cili ndodhet në veriun e Italisë, pranë Venecias. Kafshët dhe peshqit që portretizon artisti shfaqen **monumentale**, ndërkohë që shkalla e figurave njerëzore është **zvogëluar**. Kështu, dinamika e fuqisë është e kundërt. Njerëzit nuk janë më grabitqarët dhe **natyra rifiton të drejtat e saj**.

? Tani, vëreni materialin e pikturuar. Është i lëngshëm, i dendur apo i qullët? Zuccheri përdor teknikën shumë të lashtë të temperas, e cila përfshin shtimin e ujit në pigmentet e ngjyrosura. Kjo teknikë, e përdorur nga Mjeshtrit e Vjetër, ofron njëkohësisht lehtësi, tejdukshmëri dhe rrjedhshmëri gjatë vendosjes së bojës në sipërfaqe.

KRIJESË

DETI

Marguerite Humeau, *The Dead* (*a drifting, dying marine mammal*) (*I vdekuri [një gjitar detar duke lëvizur në prag të vdekjes]*), 2019

Marguerite Humeau krijon vepra misterioze që të sjellin ndër mend botën e ëndrrave. Kjo krijesë deti, që ngjan me një gjitar, duket sikur po përdor pendët e saj gjigante për t'i **shpëtuar një rreziku**. Ajo shtyhet drejt qiellit, duke shpresuar që të shpëtojë. Nëpërmjet kësaj vepre, artistja trajton problemet e **krizës klimatike** dhe **zhdukjes së specieve detare**. Ajo ngre pyetjen nëse kafshët detare e dinë se jeta e tyre është në rrezik.

? Vini re formën dhe ngjyrën e kafshës. Artistja e paraqet atë si një trup që noton në sipërfaqen e oqeanit. Cilat specie të kafshëve ju sjell ndër mend kjo krijesë?

JETESA